



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

### THIRRJE PËR APLIKIM

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të nenit 50, pika 3 e ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” kërkon të rekrutojë një ekspert të jashtëm të kualifikuar në fushën e komunikimit për asistencë në hartimin e Dokumentit Strategjik dhe Planit të Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për periudhën 2020-2022,

### TERMAT E REFERENCËS

#### Objektivi

Dhënia e asistencës së nevojshme për hartimin e Dokumentit të Strategjisë për 3 vjetarin 2020-2022, duke hartuar qëllimet strategjike të AMA-s, objektivat specifike si dhe masat dhe aktivitetet për arritjen e qëllimeve;

#### Detyrat

Eksperti, nëpërmjet dokumentit që do të dorëzojë duhet të:

1. Të parashikojë misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të autoritetit për periudhën 2020-2022;
2. Të marrë parasysh që Strategjia të përfshijë nevojën për sigurimin e përdorimit sa më të frytshëm, të dobishëm dhe përfitues të burimeve të AMA-s;
3. Të përfshijë një studim të frytshëm dhe dobishëm të dokumentit gjatë kohës së zbatimit të saj;
4. Dokumenti final duhet të jetë i shoqëruar me një plan veprimi;
5. Të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive gjatë hartimit të dokumentit;
6. Nëpërmjet strategjisë së AMA-s duhet të bëhen të qarta fuqitë ligjore të rregullatorit;
7. Strategjia duhet të përmbajë objektiva të qarta dhe të plan veprimi konkret.

#### **Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:**

1. Të zotërojë diplomën e shkollës së lartë në shkenca shoqërore.

2. Të ketë minimalisht 4 vite eksperiencë në fushën e mediave audiovizive;
3. Të njohë kuadrin rregullator i cili rregullon tregun audioviziv si dhe të njohë zhvillimet e fundit në këtë fushë;
4. Të njohë procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive;
5. Të ketë eksperiencë të mëparshme në hartimin e strategjive;

#### **Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:**

1. Diploma e shkollës së lartë në shkenca shoqërore;
2. Dokumentacioni që vërteton punë të ngjashme;
3. Fotokopje e librezës së punës që vërteton vitet e eksperiencës;
4. Jetëshkrimi;
5. Kopje ID/Pasaportë;

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

- |  |         |
|--|---------|
| 1. Diploma e shkollës së lartë;                            | 40 pikë |
| 2. Librezën e punës ku të vërtetohen vitet e eksperiencës; | 20 pikë |
| 3. Dokumentacioni për punë të ngjashme;                    | 20 pikë |
| 4. Jetëshkrimi;  | 20 pikë |

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar (original ose kopje e njësuar me origjinalion) brenda afatit pranë zyrës së arkiv-protokollit, të Autoritetit të Mediave Audiovizive.**

**Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, 1010, Tiranë**

**APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 31.01.2020**